



DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I
SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE
(Pasqyra 14 Sh)

QERSHOR, 2024

Buletini Mujoy i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga “Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike”, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin Mujoy bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS), të raportuara përmes Pasqyrës Mujoye 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin qershor 2024 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH). Të dhënat e pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat e raportuara në SISI krahasohen nga DEKSI, dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjatë muajit qershor 2024 zënë 36.2 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 236.4/100.000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 4.1/100.000 banorë. NJVKSH Berat dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastro-enterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa bashkive për diagnozën e saktë klinike dhe konfirmimin e saj me diagnozën

laboratorike mikrobiologjike. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin qershor 2024 në nivel kombëtar.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin qershor 2024 (Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste qershor 2024	Incidenca qershor 2024 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	1	0.03
Salmoneloza	9	0.3
Shigelozë (Disenteri bacilare)	7	0.2
Dizenteri amebike	0	0
Toksiko-infeksione alimentare	116	4.1
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	6634	231.8
Sëmundje diarreike në total	6767	236.4

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit qershor 2024 janë raportuar në total 204 raste variçelë (incidenca 7.13/ 100.000 banorë) nga të cilat, 117 raste janë të dyshuara dhe 87 të konfirmuara klinikisht, bazuar kjo në përkufizimin e rastit për sëmundjen variçelë. Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 62 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 80 raste, grafiku 1.


Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës, qershor 2024



2.2 Fruthi

Gjatë muajit qershor janë raportuar 3 raste si të dyshuar me fruth nga të cilët është konfirmuar 1 rast, (33.3%) raste nga ana laboratorike. Incidenca e sëmundjes për muajin qershor është 0.04 raste/100 000 banorë.

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara me fruth dhe incidenca sipas muajve 2024



Vërehet një trend i qëndrueshëm në muajt e fundit të vitit 2024.

Rasti i konfirmuar është banor i bashkisë Vlorë, i moshës 4 vjeç, i gjinisë mashkull, shtruar në spital, i vaksinuar me një dozë vaksine FRP. Të dhënat e vaksinimit janë kontrolluar në sistemin informativ elektronik të vaksinave SIV.

2.4 Pertusis

Gjatë muajit qershor janë raportuar 49 raste të dyshuar me Pertus. 23 (46.9%) e rasteve janë femra dhe 56 (53.1%) janë meshkuj. Mosha mediane e rasteve është 3 muaj. Në moshën 0-1m janë (18.4%) e rasteve, në moshën 2-3m janë (14.3%) e rasteve, në moshën 4-5m janë (14.3%) dhe në moshën 6-8m janë (6.1%) e rasteve.


Në grup-moshën <1 vjeç nuk ka raste, në grup-moshën 1-4 vjeç janë (22.4%), në grup-moshën 5-9 vjeç janë (12.2%), në grup-moshën 10-14 vjeç janë (6.1%) e rasteve dhe ≥15 vjeç janë (6.1%) e rasteve. Nga shenjat klinike mbizotëron kollë e shpeshtë dhe me aksesë mbytëse të shkurtra dhe temperaturë. Shumica e rasteve (60%) janë raportuar nga spitali pediatrik QSUT, ndjekur nga klinika “Sulçebe”, Tiranë (12.2%) dhe NJVKSH Elbasan (10.2%). Të hospitalizuar kanë qenë (71%) e totalit. 53% e të hospitalizuarve janë të moshës <1 vjeç. Verehet që 32.7% e rasteve banojnë në Tiranë ndjekur nga Elbasani (4.3%). 12.2% e rasteve janë konfirmuar dhe 87.8% janë të dyshuar klinikisht. Mosha mediane është 8 vjeç që varion nga 0 deri në 33 vjeç. Të pavaksinuar janë 8.2% e rasteve. Për çdo rast është kryer hetimi epidemiologjik dhe evidentimi i kontakteve nga NJVKSH përkatëse.

3. Hepatitet virale

3.1 Hepatit viral B (HBV)

Në muajin qershor janë raportuar 7 raste të konfirmuar me HBV. Incidenca e HBV-së në muajin qershor është 0.3 raste/100 000 banorë në vend.

Grafiku 3. Numri i rasteve të reja me HBV dhe incidenca (raste/100 000 banorë) sipas muajve




Të gjitha rastet në muajin qershor i përkasin grup-moshës adulte nga 33-59 vjeç, janë banorë nga bashkia Bulqizë (2), Durrës (2), Lushnjë (3) dhe kanë shfaqur shenja klinike të HBV.

3.2 Hepatiti viral C (HCV)

Në muajin qershor është raportuar 1 rast i konfirmuar me HCV. Incidenca e HCV në nivel kombëtar për muajin qershor është 0.07 raste/100 000 banorë.

Rasti i përket grup-moshës adulte 57 vjeç, i gjinisë mashkull, banor i bashkisë Lushnje.


Grafiku 4. Numri i rasteve të reja me HCV dhe incidenca (raste/100 000 banorë) sipas muajve



4. Sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS

Gjatë muajit qershor 2024 janë kryer 45 ekzaminime për HIV (23 femra dhe 22 meshkuj) prej të cilave 14 raste (8 meshkuj dhe 6 femra ku përfshihet edhe një fëmijë) kanë rezultuar HIV pozitiv (Grafiku 5).

Grafiku 5. Shpërndarja e testimeve për HIV dhe rasteve të konfirmuara sipas gjinisë në muajin qershor 2024.



Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitive është: Tiranë 8 raste, Lezhë 1 rast, Lushnjë 1 rast, Shkodër 1 rast, Durrës 1 rast dhe 2 raste janë shtetas të huaj. Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: 1 rast i përket grup-moshës 0-4 vjeç, 3 raste i përkasin grup-moshës 16-24 vjeç, 4 raste i përkasin grup-moshës 25-34 vjeç, 2 raste i përkasin grup-moshës 35-44 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës 45-54 vjeç dhe 2 raste i përkasin grup-moshës 55-64 vjeç.

Rastet e konfirmuara kanë ardhur 3 raste nga QSUT (Sherbimi Infektiv), 9 raste vijnë nga laboratorë privat (2 raste – INTERMEDICA, 1 rast Pegasus, 1 rast nga Cambridge dhe 5 raste nga GENIUS), dhe 1 rast është referuar si donator gjaku nga QKTGJ.

Gjatë muajit qershor 2024 janë raportuar 4 raste të konfirmuar Sifiliz, 3 raste janë nga Shkodra, dhe një rast është nga Tirana.

Gjatë muajit qershor 2024 është raportuar 1 rast i konfirmuar në laborator privat me infeksion nga Gonokokou. Rasti është i moshës 38 vjeç dhe është qytetar amerikan.

5. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit qershor 2024 janë raportuar gjithsej 13 raste me turbekuloz (TB). Prej të cilave 11 raste janë pulmonare dhe 2 raste ekstrapulmonare. Rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara dhe me sputum pozitiv. 2 prej tyre janë recidiv.Rastet pulmonare përkatësisht janë: 5 në Tiranë, 1 në Shkodër, 1 në Lezhë, 1 në Delvinë, 1 në Rrëshen, 1 në Pogradec dhe 1 në Pukë. Rastet ekstrapulmonare përkatësisht janë: 1 në Tiranë dhe 1 në Pogradec. Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pothuajse të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh.

6. Sëmundjet zoonotike

Tabela 2: Shpërndarja e zoonozave në muajin qershor 2024, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikecioze)

	Qershor (raste 2024)	Incidenca (raste/100,000) 2024
Antraks (Plasje)	0	0.00
Brucelozë	7	0.2
Leptospirozë	0	0.00


Për muajin qershor janë raportuar 7 raste me Brucelozë përkatësisht: 2 nga Gjirokastra, 2 nga Tepelena, 1 në Dibër, 1 Lezhë dhe 1 Shkodër.

7. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

7.1 COVID-19


Gjatë muajit qershor 2024 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 181 raste të konfirmuara me COVID-19, dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin prill është 6.3 raste /100000 banorë.

Grafiku 6. Shpërndarja e incidencës sipas grup-moshave



Grup-mosha më e prekur për këtë muaj është grup-mosha 65-74 vjeç me incidencë 16.7 raste për 100000 banorë, e ndjekur nga grup-mosha 55-64 vjeç me incidencë 9.55 raste për 100000 banorë.

Grafiku 7. Shpërndarja e incidencës sipas bashkive



Bashkitë me incidencë më të lartë janë Kuçovë, Himarë, Patos, etj.

Gjatë muajit qershor 2024 janë raportuar 15 raste të shtruar në spital dhe asnjë rast vdekje. Konfirmimi i rasteve është bërë në 16.1% (29 raste) në ISHP dhe 83.9% (152 raste) janë konfirmuar në laboratorët e NJVKSH-ve.

7.2 Grip

Gjatë muajit qershor nuk janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive raste të konfirmuara me grip.

8. Sëmundje të tjera

Leshmanioza Viscerale

Për muajin qershor 2024 është raportuar 1 rast i konfirmuar në laborator privat me Leshmaniozë Viscerale nga Gjirokastra.

INSTITUTI I
SHËNDETIT
PUBLIK

DEKSI